



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 131 lidhur me nenin 132 Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016 dhe konform nenit 27, 28 dhe 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni i ankesave për shqyrtimin e ankesave që janë parashtruar nga kandidatë që kanë aplikuar në konkurset për anëtarët të Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve” SH.A** me seli Suharekë dhe shqyrtimin e të gjithë procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve” SH.P.K** me seli Suharekë, në këtë përbërje:

1.1	kryesues/e
1.2	anëtar/e
1.3	anëtar/e

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të vendos lidhur me ankesat, që janë parashtruar kundër procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve” SH.A** me seli Suharekë, dhe shqyrtimin e të gjithë procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes publike lokale **“Stacioni i Autobusëve” SH.A** me seli Suharekë, komisioni lidhur me ankimin dhe procedurën vendos me vendim në këtë mënyrë;

2.1 refuzimin e ankesës dhe lënia në fuqi të procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

2.2 miratimin e ankesës dhe shfuqizimin, revokimin e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI